



Komuna e Gjakovës

## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes të

**Komuna e Gjakovës**

DHE

**OJQ "ABSM"- QENDRA EDUKATIVE**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit, (në tekstin e mëtutjeshëm Memorandumi) lidhet në mes të Komuna e Gjakovës dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative me Qender kryesore në Zvicerr dhe me degë në Gjakovë

### **Qëllimi i Memorandumit**

Qëllimi i këtij Memorandumi është që të ofrojmë një kornizë të bashkëpunimit dhe të koordinimit në mes të palëve të lartpërmendura në fushën zhvillimit profesional të nxënësve dhe mësimitdhënësve nga Komuna e Gjakovës

## **Neni I**

### **Fushëveprimtaria**

- ❖ Aktivitete të përbashkëta në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional
- ❖ Zhvillimit të kapaciteteve të mësimdhënësve
- ❖ Projekte të përbashkëta
- ❖ Këshillimi dhe orientimi, tranzicioni në vendin e punës dhe vetëpunësimi
- ❖ Vizita studimore nga Kosova në Zvicërr dhe anasjelltas.

## **Neni II**

### **Mënyra e bashkëpunimit**

Të dy palët caktojnë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit që përcakton ky memorandum.

Komuna e Gjakovës dhe ABSM pajtohen që për nevojat e tyre të shkëmbejnë ekspertët dhe përvojat e tyre në fushat të cilat mbulohen.

## **Neni III**

### **Roli i palëve.**

Palët pajtohen si më poshtë:

1. ABSM do të ofrojë shërbimet si më poshtë:
  - a) fuqizimin e kapaciteteve menaxhuese të shkollave në Komunën e Gjakovës
  - b) ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në Komunën e Gjakovës
  - c) Trajnime të ndryshme ( Këshillim në karrierë, tranzicioni në vendin e punës dhe vetëpunësimi, Edukimi për ndërmarrësinë, Mësimi në vendin e punës ,etj
2. Komuna e Gjakovës, Drejtoria e Arsimit përmes këtij memorandum zotohet për koordinimin e shërbimeve për nxënës apo mësimdhënës, në pikat si më poshtë:
  - a) Llojin e trajnimit
  - b) Kohën e fillimit të trajnimit
  - c) Perzgjedhjen e shkollave dhe
  - d) Përzgjedhjen e kandidatëve

#### Neni IV

##### Pjesëmarrja në trajnime

Trajnimet dhe këshillimet për nxënësit dhe mësime të mësuara nga Komuna e Gjakovës do të jenë falas.

#### Neni V

##### Zotimet për të ardhmen

Komuna e Gjakovës dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative do të punojnë së bashku që t'i përgjigjen kërkesave të tregut të punës dhe nevojës për zhvillim profesional

Komuna e Gjakovës dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative bashku do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional në fushën e ndërmarrësisë dhe karrierës.

#### Neni VI

##### Kohëzgjatja e Memorandunit

Ky Memorandum ka afat të pacaktuar dhe mund të plotësohet edhe me anekse tjera.

#### Neni VII

##### Zgjidhja e Memorandunit

Ky Memorandum mund të zgjidhet edhe më herët me paralajmërim paraprak prej 60 ditëve nga palët e kësaj marrëveshje.

Data:28.02.2022, Gjakovë

##### Palët nënshkruese:

Drejtorja e Arsimit Gjakovë

Eranda Baçi, Drejtor



ABSM, Gjakovë

Skender Nikoliqi, Drejtor ekzekutiv

